



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.789/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelin e Beqir Fejzullahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtërpcë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Beqir Fejzullahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtërpcë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtërpcë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë në Vendvotimin nr.2305D/ 03D, në Shtërpcë.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Beqir Fejzullahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtërpcë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë, me të cilën pretendon se në QNR gjatë rinumërimit të vendvotimit nr. 2305D/ 03D ka bërë gabim duke ndryshuar rezultatin për një votë, duke i marr nga PDK dhe i ka bart Iniciativës Shqiptare për Syrinikë në, te FRP e numërimit në vendvotim PDK ka 171 vota dhe IQ ka 165, ndërsa në formularin e rinumërimit në QNR ka dal se PDK ka 170 dhe IQ ka 166, me këtë rast janë dëmtuar për një votë të vlefshme për shkak të rezultatit të barabartë të këtyre subjekteve ku PDK ka 949 vota dhe IQ 949. Andaj ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në vendvotimin e lartë cekur. Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur formularin e numërimit në vendvotim dhe formularin e numërimit të QNR-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve në Formularët e Rezultateve të Përfundimtare në vendvotim dhe Formularët e Rezultateve të Përfundimtare të QNR-së, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenit 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*. Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.A.nr.789/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.